

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.G., nga Prishtina, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 9 lidhur me par 6 dhe 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av. A.S., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, P.nr.282/2014, të dt.27.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 29.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa mbrojtësit të akuzuarit B.G., av. A.S., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, P.nr.282/2014, të dt.27.04.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, P.nr.282/2014, të dt.27.04.2018, është shpallur fajtor i akuzuari B.G., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 9 lidhur me par 6 dhe 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, mirëpo në kuptim të nenit 47 të KPK, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi i shqiptuar me burgim i është zëvendësuar në dënimin me gjobë në shumën prej 3.050 (tremijë e pesëdhjetë) €, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet në dënimin me burgim sikurse është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi ligjor i të ndjerit F.G., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguajë në shumën prej 40 (katër dhjetë) €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit B.G., av. A.S., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit dënimi i shqiptuar, ti zëvendësohet me një dënim më të butë, sikurse është dënimi me kusht.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.697/2018, të datës 30.07.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.G., av. A.S., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.G., av. A.S., nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është dashur që të akuzuarit ti shqiptoj një dënim me kusht, ngase janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara nga neni 52 par 4 të KPK, kjo për faktin se i akuzuari që nga momenti i shkakimit të aksidentit ka treguar gatishmëri dhe përgjegjësi për rastin e ndodhur, sepse i njëjti pas aksidentit menjëherë ka lajmëruar ambulancën, se në mënyrë vullnetare është paraqitur në polici, se e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, se u ka kërkuar falje familjes së të ndjerit, se me familjen e të ndjerit janë pajtuar dhe se është penduar për veprën penale të kryer. Po ashtu, nga ekspertiza e komunikacionit është vërtetuar që lëshimet në rastin e aksidentit kanë qenë të dyanshme, si nga i akuzuari ashtu edhe nga i ndjeri, andaj, konsiderojmë se në prani të këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë është dashur që të ketë aplikuar dispozitën ligjore nga neni 74 par 3 të KPK, pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet për shqiptimin e një dënimi me kusht.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimin, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes se vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është penduar për veprën penale të kryer, se vepra penale është kryer nga pakujdesia, motivin e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, gjendjen e tij materiale, se asnjëherë më parë nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, se ka patur sjellje korrekte pas kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar peshën e veprës penale të kryer dhe sigurinë në komunikacionin rrugor të jetës së njerëzve dhe pasurisë, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese sikurse pretendon mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e ushtruar, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e

veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.690/2018, të datës 29.08.2018

Bashkëpunëtori profesional
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq